

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7811
E enjte, 13 qershor 2024
Çmimi 0.50 €

Rohde: Shpronësimi në veri s'u bë në përputhje me ligjin sipas juristëve të KiE-s FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

KOSOVA SHËNON NJË ÇEREK SHEKULLI NGA DITA E ÇLIRIMIT.

FAQE 4-5



25-vjetori i Ditës së Çlirimit të Kosovës është shënuar me prezencën e shumë personaliteteve nga vendi, Shqipëria dhe përfaqësuesve ndërkombëtarë. Kuvendi i Kosovës ka mbajtur seancë

solemne, në të cilën përfaqësues të institucioneve të Kosovës, Shqipërisë dhe miq ndërkombëtarë kanë vlerësuar rolin e jashtëzakonshëm të NATO-s, duke theksuar se 12 qershori 1999 përcaktoi përfundimisht të

ardhmen e Kosovës. Ndërkaq në praninë e shumë qytetarëve dhe personaliteteve të vendit, në sheshet e kryeqytetit kanë parakaluar njësitet e Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe të Policisë së Kosovës



Gëzuar Kosovë! DREJTËSI PËR ÇLIRIMTARËT!

Lulëzim ETEMAJ

Falë përpjekjeve të shumta, të kulmuara me luftën çlirimtare të UÇK-së dhe mbështetjen e fuqishme të shtetit amë, Shqipërisë, dhe NATO-s, prirë nga SHBA-të, Kosova sot e shënon 25-vjetorin e çlirimit.

Në rrethana normale, Kosova do të duhej ta dridhte sot Prishtinën! Do të duhej ta ngriste fuqishëm zërin kundër abuzimit dhe deformimeve të Gjykatës Speciale. Kundër shkeljes së procedurave dhe të drejtave të çlirimtarëve si dhe tendencave të hapura politike për ta rishkruar historinë e saj dhe të UÇK-së.

Nderim i përjetshëm luftës çlirimtare të UÇK-së, sakrificave dhe gjakut të derdhur të luftëtarëve të saj si dhe popullatës civile, të të gjitha gjinive dhe moshave!

Gëzuar Kosovë!
Veteranë të nderuar, gëzuar kjo ditë e shënuar!

DREJTËSI PËR ÇLIRIMTARËT
Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi, Rexhep Selimi me shokë!

Lavdi e përjetshme Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës!

ISH-PRESIDENTI CLINTON DHE AMBASADORËT E HUAJ UROJNË KOSOVËN PËR DITËN E ÇLIRIMIT

F. 3



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Stoltenbergu thotë se Hungaria u pajtua të mos e bllokojë mbështetjen e NATO-s për Ukrainën

BRUKSEL, 12 QERSHOR - Shefi i NATO-s, Jens Stoltenberg, thotë se Hungaria është pajtuar se nuk do ta bllokojë përkrahjen e aleancës për Ukrainën, por ka vendosur të mos ofrojë ushtarë apo fonde për ta ndihmuar vendin e rrënuar nga lufta.

Stoltenberg është takuar me vendet anëtare të NATO-s gjatë një turneu së voni në përpjekje për të grumbulluar mbështetje, para samitit të muajit të ardhshëm në Uashington, për zgjerimin e rolit të aleancës në përkrahjen ushtarake për Ukrainën.

Hungaria ka pasur mosmarrëveshje me vendet e tjera të NATO-s për shkak se kryeministri i saj, Viktor Orban, ka ruajtur vazhdimisht marrëdhënie të ngushta me



Rusinë dhe nuk ka pranuar t'i dërgojë armë Ukrainës për t'u mbrojtur kundër pushtuesit rus. "Hungaria nuk merr pjesë në këto përpjekje të NATO-s dhe unë e pranoj qëndrimin e saj", tha Stoltenberg për gazetarë në Budapest, pas takimit me

Orbanin më 12 qershor. "Njëkohësisht, kryeministri më ka siguruar se Hungaria nuk do t'i kundërshtojë këto përpjekje, duke ua mundësuar aleatëve të tjerë të ecin përpara. Ai ka konfirmuar se Hungaria do të vazhdojë t'i plotësojë plotësisht

detyrimet e veta në NATO", shtoi ai.

Në të njëjtën konferencë për media, Orban konfirmoi se Hungaria nuk do ta bllokojë mbështetjen e NATO-s për Ukrainën.

Prej se Rusia e nisi pushtimin e plotë të fqinjëve të vet Ukrainës në shkurt 2022, Orban ka kultivuar marrëdhënie të ngushta me Kremlinin, dhe e ka zemëruar Brukselin duke mos pranuar t'iu bashkohet sanksioneve të BE-së kundër Moskës, apo ta lejojë, siç bëjnë vendet e tjera të NATO-s, dërgimin e armëve Ukrainës.

Qeveritë perëndimore janë të pakënaqura me marrëdhëniet e vazhdueshme të ngrohta të Orbanit me Moskën, si dhe me vonesat në ratifikimin e pranimit të Suedisë në NATO, megjithëse

Budapesti e dha pëlqimin për pranimin e saj në fund.

Hungaria i kishte kërkuar aleancës ushtarake që ajo të mos merrte pjesë në dhënie të mbështetjes ushtarake për Ukrainën, në shkëmbim të lejimit të marrjes së vendimeve, që do të thotë se nuk do ta përdorë veton.

NATO-ja i merr të gjitha vendimet e veta me konsensus. NATO-ja synon ta krijojë një plan për t'i dhënë Ukrainës më shumë mbështetje ushtarake në vitet në vijim, për ta zbrapsur pushtimin rus, sepse forcat ruse, të armatosura më mirë, kanë kontrollin në fushëbetejë.

Aleanca do ta mbajë një samit muajin e ardhshëm në Uashington, ku liderët e saj synojnë ta finalizojnë planin.

ShBA-ja do t'ia dërgojë Ukrainës edhe një kundërajror Patriot

Uashington, 12 qershor - Shtetet e Bashkuara do t'ia dërgojnë Ukrainës edhe një sistem tjetër kundërajror të llojit Patriot, thanë dy zyrtarë amerikanë të martën.

Uashingtoni i është përgjigjur lutjeve dëshpëruese të Kievit për ta ndihmuar me më shumë mbrojtje ajrore, pasi është duke u përballur me sulme të përsëritura ruse në rajonin e vet verilindor, Harkiv.

Zyrtarët thanë se presidenti amerikan, Joe Biden, e ka dhënë pëlqimin për këtë vendim.

Ky do të jetë kundërajrori i dytë Patriot që Shtetet e Bashkuara ia dhurojnë Ukrainës, edhe pse Pentagoni i ka dhënë kohë pas

kohe Kievit një numër të pazbuluar raketash për këtë sistem kundërajror.

Aleatë të tjerë, përfshirë Gjermaninë, gjithashtu i kanë dhënë Ukrainës kundërajrorë dhe municione për ta.

Më 10 maj, forcat ruse e nisën një ofensivë të re në Harkiv - qytetin e dytë më të madh të Ukrainës, që ndodhet rreth 34 kilometra larg kufirit rus. Analistët e kanë përshkruar ofensivën si tentim për të krijuar "zonë neutrale", përmes së cilës mbrohet territori i Rusisë.

Kah mesi i majit, komandanti i ushtrisë ukrainase, Oleksandr Syrskiy, tha se Rusia e ka zgjeruar ofensivën në një vijë



prej 70 kilometrash, në përpjekje për të detyruar Ukrainën që t'i angazhojë edhe rezervistët.

Shtetet e Bashkuara janë ndër mbështetësit kryesorë të

Ukrainës.

Përveç ndihmës ushtarake për Ukrainën, në vlerë të 61 miliardë dollarëve, të miratuar nga Kongresi amerikan më herët gjatë vitit, presidenti amerikan

Joe Biden e propozoi në fillim të qershorit edhe një paketë tjetër në vlerë të 225 milionë dollarëve që përfshin municione, raketa, mortaja, artileri dhe raketa për mbrojtje ajrore.

Lufta në Ukrainë ka nisur më 24 shkurt të vitit 2022.

Presidenti rus, Vladimir Putin e quan luftën "operacion special ushtarak" për të çmilitarizuar Ukrainën.

Perëndimi është përgjigjur ndaj Ruisë, duke goditur ekonominë e këtij shteti me sanksione të ashpra.

Si pasojë e luftës kanë vdekur mijëra persona dhe miliona të tjerë janë zhvendosur nga shtëpitë e tyre.

ShBA-ja bën thirrje për stabilitet dhe pajtim në Ballkan, pas "kuvendit gjithëserb"

UASHINGTON, 12 QERSHOR - Shtetet e Bashkuara u kanë bërë thirrje liderëve të vendeve të Ballkanit Perëndimor t'i përdorin më mirë takimet e tyre për të promovuar pajtim dhe stabilitet rajonal, pas një tubimi të liderëve të Serbisë dhe atyre të entitetit serb të Bosnje e Hercegovinës, Republika Sërpska, i cili nxiti kritika.

Një zëdhënës i Departamentit amerikan të Shtetit tha për Radion Evropë e Lirë se ShBA-ja beson se e ardhmja e vendeve të Ballkanit është në Bashkimin Evropian, ku "bashkëpunimi rajonal dhe marrëdhëniet e mira fqinjësore sigurojnë paqe, siguri dhe begati më të madhe për të gjithë".

Të shtunën u mbledh një



"kuvend gjithëserb" në Beograd, ku udhëheqës të Serbisë dhe të Republikës Sërpska, bënë thirrje për unitetin e serbëve në të gjithë rajonin.

Tubimi u organizua nën sloganin "Një popull, një kuvend - Serbia

dhe Sërpska" dhe prodhoi të ashtuquajturën Deklaratë për mbrojtjen e të drejtave kombëtare dhe politike dhe të ardhmërisë së përbashkët të popullit serb.

Në Deklaratën e tyre të përbashkët është përmendur

edhe Kosova.

Përveç pjesës për emrin, në Deklaratë përmendet edhe që Kosova "është pjesë e patjetërsueshme e Serbisë", dhe që "kuvendi gjithëserb" mbështet përpjekjet e Republikës së Serbisë për ruajtjen e integritetit territorial dhe sovranitetit, të garantuar me ligjin ndërkombëtar, Rezolutën 1244 dhe rezolutat tjera të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.

Të hënën, Ambasada amerikane në Sarajevë e cilësoi Deklaratën e përbashkët mes Serbisë dhe Republikës Sërpska si "të rrezikshme" dhe "sulm i qëllimshëm" ndaj Marrëveshjes së Dejtonit për Paqe dhe ndaj

institucioneve të Bosnje e Hercegovinës.

Zëdhënësi i DASH-it tha se "siç e kemi bërë të qartë vazhdimisht, ne e mbështesim fuqishëm sovranitetin, integritetin territorial dhe karakterin shumetnik të Bosnje e Hercegovinës, pjesë e së cilës është edhe Republika Sërpska".

Veprimet dhe retorika e presidentit të Republikës Sërpska, Millorad Dodik, për ndarjen e entitetit serb nga Bosnja, e rrezikojnë "të ardhmen demokratike dhe paqësore brenda institucioneve euroatlantike që populli i Bosnje e Hercegovinës, përfshirë banorët e Republikës Sërpska, e dëshirojnë dhe e meritojnë".

Ish-presidenti Clinton dhe ambasadorët e huaj urojnë Kosovën për Ditën e Çlirimit

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 12 QERSHOR - Kosova e shënoi më 12 qershor 25-vjetorin e Ditës së Lirisë apo Çlirimit të Kosovës, kur trupat paqeruajtëse të NATO-s hynë në Kosovë pas fushatës ajrore të aleancës veriatlantike kundër caqeve ushtarake e policore serbe në Kosovë dhe Serbi.

Ish-presidenti i Shteteve të Bashkuara, Bill Clinton, shkroi në rrjetin social "X" se ndihet mirënjohës për 25 vjet paqe në Kosovë.

Clinton është nderuar në Kosovë për kontributin e tij në çlirimin dhe pastaj pavarësimin e vendit nëntë vjet më pas. Në Prishtinë, në sheshin e emëruar për nder të Clintonit ndodhet edhe një shtatore e tij, ndërsa aty afër është hapur edhe një dyqan rrobash i emëruar Hillary, për nder të Zonjës së Parë të atëhershme të ShBA-së, Hillary Clinton.

Clinton luajti rol kyç në çlirimin e Kosovës më 1999, pasi punoi me aleatët e tjerë të NATO-s për ndërmarrë veprime ushtarake në mbrojtje të popullit të Kosovës. "Mund t'i raportoj popullit amerikan se kemi shënuar fitore - për një botë më të sigurt, për vlerat tona demokratike dhe për një Amerikë më të fortë", tha Clinton 25 vjet më parë.

Ambasadori amerikan në Prishtinë, Jeffrey Hovenier, e uroi popullin e Kosovës për Ditën e Çlirimit dhe theksoi se Shtetet e Bashkuara do të vazhdojnë të qëndrojnë përkrah popullit kosovar. "Tani, 25 vjet më vonë, ne jemi krenarë për gjithçka që kemi arritur. Ju e keni ndërtuar shtetin tuaj sovran, demokratik dhe shumetnik nga themeli. Ajo që e keni arritur ju, është e jashtëzakonshme", tha Hovenier.

Ai theksoi në një video mesazh të publikuar në rrjetin social X se Shtetet e Bashkuara janë krenare që janë partneri i Kosovës në ditën kur ajo e shënon njërin prej momenteve më të rëndësishme në historinë e



vet. "Dua të theksoj se përkushtimi i Shteteve të Bashkuara të Amerikës ndaj popullit të Kosovës është po aq i fortë dhe i qëndrueshëm si gjithmonë. Ne qëndrojmë pranë popullit të Kosovës kundër autoritarizmit; kundër përpjekje për ta shtypur apo ndarë shoqërinë në vija etnike ose fetare; kundër shkatërrimit me dhunë të jetës dhe jetesës së njerëzve kundër vullnetit të tyre. Ne qëndrojmë me krenari dhe plotësisht përkrah popullit të Kosovës", shtoi ai.

Ambasadori gjerman në Prishtinë, Jorn Rohde, tha se Gjermania është dhe do të mbetet ndër partnerët më të ngushtë të Kosovës. "Sot, para 25 vjetëve, nisi misioni i NATO-s, KFOR. E citoj ish-sekretarin britanik të Mbrojtjes dhe ish-shefin e NATO-s, Lord Robertson: Synimi ishte largimi i forcave të Millosheviqit, futja e NATO-s dhe kthimi i refugjatëve.

Misioni u kompletua. Pavarësia u shpall më 2008 dhe është storje e suksesit", ka shkruar ai.

Dita e Çlirimit u shënua me disa ceremoni, përfshirë mbajtjen e një seance solemne në Kuvendin e Kosovës, si dhe parakalimin e njësisë të Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe të Policisë së Kosovës.

Të mërkurën u bënë 25 vjet nga dita kur forcat paqeruajtëse të NATO-s hynë në Kosovë, duke shënuar fundin e luftës që la më shumë se 13.500 njerëz të vrarë, kryesisht shqiptarë.

Fushata bombarduese e NATO-s, që zgjati 78 ditë, përfundoi më 10 qershor 1999, pas miratimit të Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB), me kapitullimin e Serbisë dhe tërheqjen e forcave të saj nga Kosova.

Rezoluta 1244 e OKB-së në Kosovë

vendosi administratën e përkohshme të OKB-së, UNMIK, për të administruar me vendin e shkatërruar nga lufta, për një periudhë tranzitore deri në ngritjen e kapaciteteve vendore dhe zgjidhjen e statusit të Kosovës.

Ajo, po ashtu, siguroi bazën ligjore për vendosjen e 50.000 trupave paqeruajtëse të udhëhequra nga NATO-ja për ta siguruar paqen në Kosovë, që njëherësh ishte edhe misioni më i madh paqeruajtës i Aleancës veriatlantike.

Vendosjes së trupave paqeruajtëse i parapriu Marrëveshja Teknike e Kumanovës, që parashihte tërheqjen e të gjitha forcave serbe nga Kosova dhe hyrjen e trupave ndërkombëtare të NATO-s në Kosovë.

Tërheqja e plotë e trupave serbe përfundoi më 20 qershor 1999. Ushtarët e parë që u futën brenda territorit të Kosovës më 1999 ishin

pjesëtarë të ushtrisë norvegjeze. Ata ishin pjesë forcave paqeruajtëse nga 36 vende të botës - prej të cilëve 30.000 ishin të shteteve të NATO-s - që erdhën në Kosovë.

Me hyrjen e trupave ndërkombëtare u mundësua kthimi në shtëpitë e tyre i më shumë se 800.000 refugjatëve, persona të zhvendosur brenda dhe jashtë Kosovës, të dëbuar nga shtëpitë e tyre, që po strehoheshin në kampe në Shqipëri dhe Maqedoni të Veriut, si dhe largimin e serbëve nga Kosova.

Nga ana tjetër, tërheqja e forcave serbe çoi në shpërnguljen e rreth 164.000 serbëve nga Kosova.

Ndërhyrja ushtarake e NATO-a ndodhi pas gati një dekade përpjekjesh diplomatike ndërkombëtare për t'i ndaluar luftërat në ish-Jugosllavi. Në Kosovë, asaj i parapriu Konferenca e Rambujesë dhe e Parisit, ku Serbia refuzoi kompromisin që të ndalte dhunën e forcave të saj në Kosovë.

Në luftën e viteve 1998-'99 janë vrarë më shumë se 13.000 persona dhe janë zhdukur më shumë se 6.000 persona.

Qindra shqiptarë të vrarë nga Kosova janë gjetur në varreza masive në Serbi. Trupat e tyre janë bartur nga forcat serbe me qëllim që të fshihen krimet.

Udhëheqësit politikë dhe ushtarakë të Serbisë janë arrestuar, gjykuar dhe dënuar nga Gjykata Ndërkombëtare e Hagës për ish-Jugosllavi për krimet kundër njerëzimit të kryera në Kosovë.

Ndër ta ishte edhe Slobodan Millosheviq, i cili vdiq në burg pa arritur të dënohet për përgjegjësinë në urdhërimin e krimeve të luftës në Kosovë.

Sipas të dhënave, më shumë se 1.600 persona konsiderohen ende të pagjetur.

Njëzetepesë vjet pas hyrjes në Kosovë, numri i trupave të KFOR-it është zvogëluar dhe aktualisht në vend janë mbi 4 mijë trupa nga 28 shtete të botës.





Kosova shënon një çerek shekulli nga Dita e Çlirimit

25-vjetori i Ditës së Çlirimit të Kosovës është shënuar me prezencën e shumë personaliteteve nga vendi, Shqipëria dhe përfaqësuesve ndërkombëtarë. Kuvendi i Kosovës ka mbajtur seancë solemne, në të cilën përfaqësues të institucioneve të Kosovës, Shqipërisë dhe miq ndërkombëtarë kanë vlerësuar rolin e jashtëzakonshëm të NATO-s, duke theksuar se 12 qershori 1999 përcaktoi përfundimisht të ardhmen e Kosovës. Ndërkaq në praninë e shumë qytetarëve dhe personaliteteve të vendit, në sheshet e kryeqytetit kanë parakaluar njësitet e Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe të Policisë së Kosovës

EPOKA E RE**Mal QORRAJ**

PRISHTINË, 12 QERSHOR - Kosova të mërkurën ka shënuar 25-vjetorin e Ditës së Çlirimit, kur trupat paqeruajtëse të NATO-s hynë në Kosovë pas fushatës ajrore të aleancës veriatlantike kundër çaqeve ushtarake e policore serbe në Kosovë dhe Serbi. Me aktivitete të ndryshme shtetërore është shënuar kjo datë. Kuvendi i Kosovës e mbajti një seancë solemne më 12 qershor për nder të 25-vjetorit të Ditës së Lirisë

apo Çlirimit të Kosovës, kur forcat paqeruajtëse të NATO-s hynë në Kosovë, duke shënuar fundin e luftës që la më shumë se 13.500 njerëz të vrarë, kryesisht shqiptarë. Seanca nisi me këndimin e himnit shtetëror të Kosovës dhe himnit kombëtar shqiptar, si dhe me një minutë heshtje për të gjithë të rënë në luftën e viteve 1998-'99. Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, duke folur në seancën solemne, tha se hyrja e NATO-s në Kosovë ishte "triumf i të mirës ndaj të keqes dhe triumf i drejtësisë mbi shtypjen".

Parakalimi i njësitëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe Policisë së Kosovës

Për nder të 25-vjetorit të çlirimit të Kosovës, në praninë e shumë qytetarëve dhe personaliteteve të vendit, Shqipërisë dhe miqve ndërkombëtarë, në sheshet e kryeqytetit kanë parakaluar njësitet e Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe të Policisë së Kosovës. Presidentja Vjosa Osmani, kryeministri Albin Kurti dhe ish-sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Lord George Robertson i janë drejtuar me fjalime masës së pranishme.

Robertson në fjalën e tij tha se qëllimi i tyre ishte që ta përmbushin obligimin e misionit të tyre në atë kohë; largimin e ushtrisë së Millosheviqit, hyrjen e trupave të NATO-s dhe kthimin e refugjatëve në shtëpi, duke theksuar se është krenar që sot sheh një Kosovë multietnike dhe paqësore në zemrën e Evropës.

Osmani në fjalimin e saj para deputetëve të Kuvendit të Kosovës tha se NATO solli mesazhin se nuk e kishte harruar Kosovën. "Ata nuk ishin vetëm ushtarë, ata ishin shpëtimtarë, ata sollën me vete premtimin e lirisë, sigurinë se bota nuk kishte harruar për popullin e Kosovës, dhe vendosmërinë për t'i dhënë fund mizorive të kryera kundër popullit tonë", tha ajo. Osmani po ashtu tha se sot Kosova e meriton të jetë pjesë e aleancës së NATO-s. Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, tha se "sot e shënojmë 25 vjetorin e

çlirimit të Kosovës duke qëndruar së bashku me aleatët tanë, njësoj si më 12 qershor dhe njësoj si në ditët e para të çlirimit". Ai theksoi se dëshiron që në Kosovën "tonë demokratike, pikërisht pse kemi humbur dhe vuajtur kaq shumë" të gjithë qytetarët pa dallim etnie "të gëzojnë dhe të fitojnë; shumica shqiptare bashkë me pakicat serbe, boshnjake, turke, ashkalinjtë, romët, egjiptianët, por edhe me kroatët dhe malazezët" "Sikur atëherë dhe tani, Serbia rri e rreshtuar prapa Rusisë, ashtu siç





Rusia qëndron prapa shumë veprimeve të Serbisë, kurse shteti jonë Kosova, bashkë me Shqipërinë, ka shkuar duke i forcuar lidhjet dhe aleancën e saj me Shtetet e Bashkuara, me Britaninë e Madhe, Gjermaninë, Turqinë, Francën Italinë dhe vendet e tjera perëndimore. Bashkimi Evropian është familja jonë e synuar politike, kurse NATO-ja është destinacioni ynë ushtarak”, shtoi Kurti.

Presidenti i Shqipërisë, Bajram Begaj, me këtë rast, ndër të tjera, tha se shqiptarët kanë nevojë për të ruajtur dhe forcuar kohezionin e tyre kombëtar dhe social kulturor edhe sot, “në një kohë kur Serbia dhe aleatët e saj kanë mobilizuar kapacitetet diplomatike dhe mediatike në një fushatë thellësisht keqdashëse për të njoollur luftën e drejtë dhe parimore të shqiptarëve për çlirimin e Kosovës. “Ne kemi nevojë më shumë se kurrë që të jemi bashkë. Ne kemi nevojë më shumë se kurrë për një manifest krenarie kombëtare”.

Ai tha se Shqipëria do të vazhdojë të llojë për Kosovën për njohje të

reja dhe integrimin e saj ne organizata ndërkombëtare. Ish-presidenti i Kroacisë, Stipe Mesiç, tha se Bashkimi Evropian është shtëpi e përbashkët e rajonit dhe NATO-ja një ombrellë e përbashkët e sigurisë dhe ekonomike. “Pikërisht këtë po e theksoj këtu, në Prishtinë, në Republikën e Kosovës, duke shënuar 25 vjet nga çlirimi i Kosovës, para së gjithash falë UÇK-së, me ndihmën e bashkësisë ndërkombëtare, veçanërisht të

aleancës së NATO-s dhe ShBA-së”, Edhe pse mendohej se koha më e vështirë kishte kaluar, shtoi ai, ka ende nevojë për veprim dhe prani të bashkësisë ndërkombëtare në rajon, jo vetëm në Kosovë por edhe në Bosnje-Hercegovinë. “Ne duhet të jemi gjithmonë të gatshëm të përballlemi me shumë sfida, në fakt sfida të vjetra që janë ridizajnuar. Mund të them lirshëm se arkitektura kufitare në rajon u kompletua me shpalljen e pavarësisë së Republikës së Kosovës.



Fatqësisht, ka ende kërcënime dhe rreze nga të ashtuquajturat projekte megashtetërore. Paqja dhe stabiliteti duhet të jenë vendet tona të shenjta që duhet të sigurojnë prosperitetin e të gjithëve ne. Përgjigja më e mirë për të gjitha sfidat dhe kërcënimet është perspektiva euroatlantike”, shtoi ai. Kryeparlamentari Glauk Konjufca tha se shteti serb kishte “vetëm një synim: shfarosja e një populli të tërë” nga territori dhe përmes krimeve të cilat “morën përmasën e gjenocidit”. “Për ne, Serbia mbeti e njëjtë, pavarësisht a u quajt dikur Mbretëri Jugosllave, a u quajt pastaj Jugosllavi Federative a Socialiste. Politikat e shtypjes, e dëbimit, e shpronësimeve, e diskriminimit dhe e nënçmimit, kanë qene tipari konstant i secilit prej këtyre regjimeve”, tha Konjufca.

I pranishëm në seancë është edhe shefi i atëhershëm i Misionit Verifikues të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), Eëlliam Eëalker.

Eëalker luajti rol kyç në dokumentimin e masakrës në Reçak të Shtimes, ku forcat serbe vranë 45 civilë shqiptarë më 15 janar të vitit 1999. Eëalker e cilësoi ngjarjen si krim kundër njerëzimit. Fushata bombarduese e NATO-s, që zgjati 78 ditë, përfundoi më 10 qershor 1999, pas miratimit të Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB), me

kapitullimin e Serbisë dhe tërheqjen e forcave të saj nga Kosova.

Me hyrjen e trupave ndërkombëtare u mundësua kthimi në shtëpitë e tyre i më shumë se 800.000 refugjatëve, persona të zhvendosur brenda dhe jashtë Kosovës, të dëbuar nga shtëpitë e tyre, që po strehoheshin në kampe në Shqipëri dhe Maqedoni të Veriut.

Konjufca e Nikolla nderuan fëmijët e vrarë në luftë

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, së bashku me kryetaren e Kuvendit të Shqipërisë, Lindita Nikolla, bëri homazhe në nderim të 1133 fëmijëve të vrarë nga forcat pushtuese serbe gjatë luftës në Kosovë. Pranë pllakës përkujtimore për fëmijët e vrarë, të vendosur në oborrin e Kuvendit, të dy kryetarët vendosën lule të freskëta, duke kujtuar gjithashtu se liria jonë erdhi me sakrificë e dhimbje të papërshkrueshme, me shumë jetë të pafajshme të ndërprera në mes, ndër to edhe këta fëmijë që nuk u kursyen nga aparati kriminal i shtetit serb. Konjufca tha se sot ndajmë triumfin e lirisë, por ndajmë edhe dhimbjen, duke iu përkulur së bashku veprës sublime të të rënëve, me zotimin për drejtësi ndaj tyre, e me përkushtim që me punën tonë



Limaj merr pjesë në inaugurimin e “Kalasë së UÇK -së” në Prizren

PRIZREN, 12 QERSHOR - Kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, i shoqëruar nga bashkëpunëtorë ka marrë pjesë në inaugurimin e kompleksit “Kalaja e UÇK-së”, në Arbëri të Vërrinit në Prizren, ku janë të lartësuar tri shkronjat e historisë sonë të artë “UÇK”, në nderim të luftës së lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe sakrificës së madhe të popullit shqiptar në luftën për liri.

Në këtë ngjarje të rëndësishme, ku të pranishëm ishin personalitete të shumta që kanë dhënë shumë për vendin, në një fjalë rasti, kryetari Limaj tha se, në vitin 1998, kur Komandanti Legjendar Adem Jashari e lëshoi kushtimin anekënd Kosovës, çdo cep i Kosovës iu përgjigj pozitivisht, madje çdo kodër e çdo bjeshkë e vendit tonë u rreshtua pranë sakrificës dhe trimërisë së Komandantit Legjendar.

Simbolika e kësaj kodre është po aq sa në atë kohë, kur në Prekaz krisi pushka, ku në atë moment Serbia e kishte ngritur në këmbë gjithë Kosovën, më ç’rast Ushtria Çlirimtare e Kosovës jehoi kudo, madje edhe në këtë kodër, në të gjitha fushat e malet e kësaj zone. Gjithashtu, kryetari Limaj gjatë fjalës së tij, tha se, është moment i veçantë, fakti se përrurimi i këtij kompleksi, po bëhet sot, pikërisht në Ditën e Çlirimit të Prizrenit, qytetit tonë historik.

Limaj ka shprehur mirënjohje dhe respekt për të gjithë veteranët, iniciatorët, shumë burra e gra të cilët kanë kontribuar për të lartësuar këto shkronja të arta e të shenjta “UÇK” në Prizren. “Lavdi gjithë dëshmorëve të kombit, nder dhe respekt gjithë atyre të cilët lartësojnë, nderojnë e vlerësojnë luftën e UÇK-së”, ka thënë në fund Limaj.



Sekuestrohen parfume në vlerë rreth 95 mijë euro në Obiliq

OBILIQ, 11 QERSHOR - Policia e Kosovës ka vazhduar luftën kundër dukurive negative dhe kontrabandës. Si rrjedhojë është realizuar një kontroll në gjashtë lokacione në Obiliq. "Policia e Kosovës, respektivisht njësitë

relevante policore në bashkëpunim me institucionet kompetente si Prokuroria, Dogana dhe Administrata Tatimore e Kosovës kanë zbatuar urdhrin e gjykatës, ku janë kontrolluar gjashtë lokacione të ndryshme dhe janë sekuestruar

10,480 copë parfume në vlerë prej 94,320 euro dhe dëshmi tjera materiale", thuhet në njoftim. Në cilësinë e të dyshuarve janë intervistuar tre persona të cilët në konsultim me prokurorin janë liruar në procedurë të rregullt.



25-vjetori i çlirimit të Prizrenit, Totaj nderon dëshmorët

PRIZREN, 12 QERSHOR - Në nderim të heronjve të kombit, kryetari i Prizrenit, Shaqir Totaj, së bashku me zyrtarë të ekzekutivit, familje të dëshmorëve, përfaqësues të shoqatave të dala nga lufta e

UÇK-së, veteranë, invalidë të luftës dhe qytetarë të shumtë, kanë bërë homazhe të mërkurën në varrezat e Dëshmorëve në Landovicë, duke përkujtuar 25-vjetorin e Çlirimit të Prizrenit. Me krenari kujtuan sakrificën e

atyre që dhanë jetën për lirinë e vendit që ka rëndësi të veçantë në ruajtjen e kujtesës historike dhe vlerave të lirisë. "Jeta dhe vepra e dëshmorëve nuk do të harrohen kurrë! Lavdi!", u shpreh Totaj.

Komuna e Podujevës dhe ShSKUK-ja nënshkruan marrëveshje për objektin e Poliklinikës Specialistike

PODUJEVË, 12 QERSHOR - Kryetari i Komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi dhe drejtori i Shërbimit Spitalor, Klinik Universitar të Kosovës (ShSKUK), Elvir Azizi, nënshkruan marrëveshje për shfrytëzimin afatgjatë të objektit që është i dedikuar për Poliklinikë Specialistike. Ky objekt, që është pronë e Komunës së Podujevës, në bazë të kësaj kontrate i jepet ShSKUK-së në shfrytëzim afatgjatë pa pagesë. Ndërkohë, ShSKUK-ja do të bëjë



rekrutimin e infermierëve dhe blerjen e disa pajisjeve të nevojshme, për të cilat tashmë i kanë nisur procedurat e

prokurimit. Pas nënshkrimit të marrëveshjes-kontratës, kryetari Bulliqi u shpreh i lumtur që qytetarëve të Podujevës shumë shpejt do t'u ofrohen shërbime specialistike në komunën e tyre, për të cilat deri tash janë detyruar të udhëtojnë në Prishtinë. Të pranishëm në këtë ceremoni kanë qenë edhe ministri për Shëndetësi, Arben Vitia dhe drejtoresha e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale e Podujevës, Adelina Stublla.

Rama nderon me 'Çelësin e Qytetit' gazetarin e BBC-së, David Loyn

PRISHTINË, 12 QERSHOR - Kryetari i Komunës së Prishtinës, Përparim Rama, ka nderuar me "Çelësin e Qytetit" gazetarin e BBC-së, David Loyn. Ai ka thënë se raportimi nga zona e luftës në Kosovë gjatë viteve 1998-1999 ishte jetik për të sjellë informacionin e rëndësishëm dhe për të sensibilizuar opinionin ndërkombëtar për situatën e rëndë në luftën humanitare në vendit tonë. "Gazetari i BBC-së,

David Loyn, me raportimet e tij dokumentoi atë se çfarë po ndodhte, shfaqti të vërtetën për dëmet ndaj popullsisë civile në Kosovë që po shkaktoheshin nga aparati shtetëror serb. Përmes këtij dokumentimi, ai kontribuoi në mobilizimin e ndihmës ndërkombëtare dhe në përgatitjen e një reagimi ndërkombëtar për të ndihmuar popullsinë lokale. I jemi përjetë mirënjohës për kontributin e tij të veçantë!", ka thënë Rama.



Hyseni: Premtimet e dhëna po jetësohen, lidhen me rrugë fshatrat e Gjilanit me ato të Preshevës

GJILAN, 12 QERSHOR - Pa ndalur po vazhdojnë investimet në fshatrat e Komunës së Gjilanit, përkatësisht rreth brezit kufitar që lidhin fshatrat e Gjilanit me ato të Preshevës. Kjo po bëhet me qëllim të përmirësimit të

kushteve për jetë më të mirë për banorët e fshatrave. Një investim me rëndësi ka filluar për asfaltimin e rrugës në fshatin Kokaj. "Me vlerë 569,135.37 euro e gjatësi 3261,55 metra, kanë filluar

punimet në rrugën e fshatit Kokaj", tha kryetari i Komunës së Gjilanit, Alban Hyseni. Sipas tij, infrastruktura e re që po punohet, përveç zhvillimit të fshatrave të komunës sonë, do të shërbejë edhe për lidhjen

e shumë fshatrave të Preshevës me Gjilanin. "Premtimet e dhëna po jetësohen, punët nuk do të ndalen. Shumë projekte tjera presim të fillojnë", tha i pari i Gjilanit, Alban Hyseni.



Rohde: Shpronësimi në veri s'u bë në përputhje me ligjin sipas juristëve të KiE-s

PRISHTINË, 12 QERSHOR - Ambasadori gjerman në Prishtinë, Jorn Rohde, tha se vendimi i Qeverisë së Kosovës, për finalizimin e shpronësimit të mbi 100 parcelave në komunat me shumicë serbe në veri të vendit, nuk u bë në përputhje me ligjin sipas një raporti të juristëve eminentë të Këshillit të Evropës (KiE). "Pas reagimit të Qeverisë [së Kosovës] ndaj deklaratës së QUINT-it, BE-së dhe OSBE-së për shpronësimin, më lejoni ta citoj raportin e juristëve eminentë të KiE-së: 'Kjo mënyrë e veprimit nuk është në përputhje me sundimin e ligjit dhe me gjasë do ta minojë edhe më shumë besimin mes komunitetit serb dhe institucioneve qeveritare të Kosovës', shkroi Rohde në rrjetin social "X".

Më 5 qershor, Radio Evropa e Lirë raportoi për vendimin përfundimtar të Qeverisë kosovare për shpronësimin e tokave në Leposaviq dhe Zubin Potok, i cili përjashton disa parcela private, por vetëm të



atyre qytetarëve që e kanë fituar procesin në gjykatë. Ky vendim u kritikua nga vendet e Quint-it, Bashkimi Evropian (BE) dhe Misioni i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në

Evropë në Kosovë (OSBE). Quint-i, BE-ja dhe OSBE-ja thanë se "përderisa disa nga pronat e paraqitësve të kërkesës u hoqën nga vendimi përfundimtar i shpronësimit, na

vjen keq që Qeveria e Kosovës nuk priti që të gjitha procedurat e hapura gjyqësore të gjykoreshin plotësisht përpara se të merrte këtë vendim". Në një përgjigje ndaj tyre më 6

qershor, Qeveria e Kosovës tha se deklarata e tyre e përbashkët "konstaton në mënyrë të gabuar gjendjen faktike dhe bën vlerësim ligjor të pabazuar në argumente", dhe se Qeveria e kishte pritur vendimarrjen e gjykatave para se të vazhdonte me vendimin përfundimtar. Rohde tha se Kosova, e cila synon t'iu bashkohet organizatave si BE, OSBE dhe KiE, duhet t'i marrë parasysh këshillat e tyre. "Ne nuk jemi këtu për të ndëshkuar, por për të mbështetur", shkroi Rohde. Gjykata e Apelit e Kosovës ka konfirmuar për Radion Evropa e Lirë më 5 qershor se shqyrtimi i një vendimi të Gjykatës Themelore lidhur me këtë çështje është ende në vazhdim. Gjykata Themelore në Prishtinë e kishte refuzuar shumicën e padive të qytetarëve serbë, të cilët paditën Qeverinë e Kosovës dhe kërkuan të "vërtetohet se nuk ekziston interes i veçantë publik për pasuritë e paluajtshme të paditësve".

Lajçaku thotë se njoftoi Këshillin e Evropës dhe vendet e BE-së për situatën e dialogut Kosovë-Serbi

PRISHTINË, 12 QERSHOR - I dërguari i posaçëm i Bashkimit Evropian për dialogun Kosovë-Serbi, Miroslav Lajçak, ka bërë me dije se i ka njoftuar anëtarët e Këshillit të Evropës (KiE) dhe vendet anëtare të bllokut për gjendjen e tanishme të dialogut mes dy vendeve fqinje. "Gjatë qëndrimit në Strasburg, e shfrytëzova rastin gjithashtu të bashkëveproj me një numër të zyrtarëve të Këshillit të Evropës për dosjet tona përkatëse", ka shkruar Lajçak në "Facebook", duke shtuar se udhëtoi në Francë me ftesë të anëtarëve të KiE-së. Nën Lajçakun, Kosova dhe Serbia më 2023 arritën Marrëveshjen drejt normalizimit të marrëdhënieve. Më vonë ajo u bë e njohur si Marrëveshja e Ohrit, por edhe ajo ka mbetur kryesisht e pazbatuar.

Kosova dhe Serbia janë në negociata për më shumë se një dekadë, por shumë prej marrëveshjeve që kanë arritur, nuk i kanë zbatuar. Të dyja palët fajësojnë njëra-tjetrën për mungesë gatishmërie.



Kosova është nën trysni ndërkombëtare në veçanti për ta themeluar një Asociacion të komunave me shumicë serbe. Mosbërja e hapave në këtë drejtim e ka penalizuar Kosovën me mosantaresim në Këshillin e

Evropës – organizatën lidere për të drejta të njeriut - më herët gjatë këtij viti.

Kosova dhe Serbia arritën marrëveshje për Asociacionin më 2013 dhe më pas më 2015 mbi parimet për themelimin e tij. Më

2015, Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka gjetur se marrëveshja nuk është në harmoni të plotë me Kushtetutën.

Serbia kërkon që Kosova të zbatojë marrëveshjet e arritura, por Qeveria e Kosovës është deklaruar kundër një asociacioni njëetnik.

Dje ambasadori i Shteteve të Bashkuara në Kosovë, Jeffrey Hovenier, tha se dialogu mes Kosovës dhe Serbisë është një sfidë që duhet tejkaluar vetëm me njohje reciproke dhe jo diçka më pak. "Përfundimi i këtij procesi duhet të jetë njohja mes dy vendeve, sepse diçka më pak se kjo nuk e përmbush këtë vizionin që e kemi për një Evropë të plotë, të lirë, të begatshme dhe në paqe", tha ai.

Në prill, BE-ja e kushtëzoi zyrtarisht integrimin e Serbisë në këtë bllok me normalizimin e marrëdhënieve me Kosovën, ndërsa ndaj Kosovës mban në fuqi masa ndëshkuese, të cilat u ndërmorën qysh vitin e kaluar, pas përshkallëzimit të tensioneve

në veri.

Bashkimi Evropian është duke shqyrtuar edhe si t'i qaset dialogut për normalizimin e marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë, por edhe kandidatët potencialë për ta ndërmjetësuar atë.

Lajçak është emëruar ambasador i BE-së në Zvicër, ku duhet të nisë mandatin më 1 shtator, blloku po mendon për ta gjetur pasardhësin e tij.

Në mesin e kandidatëve potencialë, nga burimet diplomatike në BE përmenden edhe ish-ministri i Jashtëm i Finlandës, Pekka Haavisto, dhe diplomati danez, Peter Sorensen, të cilët kanë edhe përvojë nga rajoni i Ballkanit Perëndimor.

Burimet e BE-së thonë se, kushdo që të jetë në atë post dhe pa marrë parasysh se kush do të jetë përfaqësues i lartë i BE-së për politikë të jashtme dhe siguri, do të duhet të insistojë në zbatimin e të gjitha marrëveshjeve që Kosova dhe Serbia kanë arritur deri më tash në dialog.

Haradinaj: Kosova dhe Quint-i duhet t'i japin përgjigje Serbisë me hapjen e Urës së Ibrit

Prishtinë, 12 qershor - Kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka thënë se përgjigja më e mirë e Kosovës dhe e vendeve të Quint-it ndaj Serbisë është të hapet Ura e Ibrit në Mitrovicë.

Në një postim në "Facebook", Haradinaj ka shkruar se Serbia brenda një

jave dy herë e ka poshtëruar bashkësinë ndërkombëtare me të ashtuquajturin 'Kuvendin gjithëserb'. "Brenda një jave Serbia dy herë 'poshtëroi' Bashkësinë Ndërkombëtare dhe Quint-in me të ashtuquajturin 'Kuvendi gjithëserb', ku u dhanë deklaratat mesjetare e po ashtu edhe Vulin nga



Moska me deklaratat e tij mesjetare të cilat bien ndesh me thirrjet ndërkombëtare për stabilitet në Ballkanin Perëndimor. Bashkësia Ndërkombëtare dhe Kosova përgjigjen më të mirë do t'ia jepte Vulinit dhe të gjithëve me mendësi të tillë, me hapjen e Urës së Ibrit", ka shkruar Haradinaj.

'Roli i Auditorit të Përgjithshëm është të ofrojë bazë të qëndrueshme të vlerësimit për mbylljen e procesit të llogaridhënies'

PRISHTINË, 12 QERSHOR - Auditorja e Përgjithshme, Vlora Spanca, mori pjesë në cilësinë e panelistes në tryezën e diskutimit të organizuar nga Instituti GAP, ku u prezantua raporti me temën "Nevoja për themelimin e një Institucioni të Pavarur Fiskal në Kosovë". Në tryezë morën pjesë përfaqësues të lartë të institucioneve vendore dhe regjionit të cilët diskutuan për përparësitë dhe sfidat për të siguruar stabilitet financiar si dhe qëndrueshmërinë dhe monitorimin e politikave

fiskale në Kosovë. Auditorja e Përgjithshme ka paraqitur pikëpamjet e saj nga perspektiva e auditimit të jashtëm, mandatit dhe rolit që luan një Institucion Suprem i Auditimit me qëllim të forcimit të mekanizmave shtetëror në menaxhimin e financave publike dhe përmirësimit të qeverisjes së mirë nga institucionet publike. Spanca u shpreh se roli i Auditorit të Përgjithshëm është që të ofrojë bazë të qëndrueshme të vlerësimit për mbylljen e procesit të

llogaridhënies në mes Kuvendit dhe Qeverisë për realizimin e buxhetit shtetëror gjatë vitit. "Pavarësisht indikatorëve pozitiv dhe qëndrueshmërisë fiskale për vendin, edhe Zyra Kombëtare e Auditimit, por edhe Fondi Monetar Ndërkombëtar nxjerrin në pah sfidat në lidhje me shfrytëzimin efikas dhe efektiv të borxhit publik, rreziqet nga kostot kontingjente nga proceset gjyqësore si dhe nga ndikimet tjera makroekonomike që ndikojnë në parametrat e



buxhetit", tha Spanca. Ajo u shpreh se edhe pse është më shumë në favor të forcimit të mekanizmave

ekzistues sesa krijimit të mekanizmave të rinj, vendimarrja i takon politikëbërësve.

Shënohet rritje e sipërfaqes së tokës bujqësore në vitin 2023

PRISHTINË, 12 QERSHOR- Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar rezultatet e Anketës së Ekonomive Bujqësore (AEB) për vitin 2023. Gjatë vitit 2023, rezultatet e kësaj ankete tregojnë se sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore ishte 420 688,21ha (përfshirë tokën e përbashkët), ku krahasuar me vitin paraprak 2022 (që ishte 420 482,46 ha) ka një rritje të sipërfaqes së tokës në shfrytëzim prej 205,76 ha.

Rënie e lehtë e vërehet te toka e përbashkët

Nga gjithsej sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore në vitin 2023, pjesa më e madhe u përket livadheve dhe kullosave (përfshirë tokën e përbashkët) ishte 216 979,55 ha (51,58%), krahasuar me vitin paraprak 2022 (që ishte 216 979,55 ha) ose 51,61%.

Rritje e lehtë e sipërfaqes së tokës me kultura shumëvjeçare

Sipërfaqja e tokës me kultura shumëvjeçare (pemët, vreshtat, fidanët) në vitin 2023 ishte 14 210,86 ha me



pjesëmarrje prej 3,38 % të sipërfaqes së përgjithshme, ku krahasuar me vitin 2022 (që ishte 13 999,84 ha, me pjesëmarrje 3,33 %), vërehet një rritje e lehtë e kulturave shumëvjeçare në tokën e shfrytëzuar bujqësore.

Gjatë vitit 2023, gjithsej toka e punueshme - arat, ishte 188 435,41 ha, pjesa më e madhe ishte me: drithëra (124 680,68 ha, ose 66,17%); bimë foragjere (37 563,77 ha, ose 19,93%); perime 10 234,81 ha në fushë të hapur, në serra dhe kopshte

(prej të cilave perime në fushë të hapur dhe serra ishin 9 172,42 ha, ose 4,87%); patate (3 917,53 ha, ose 2,08%); bishtajore (3 078,11 ha, ose 1,63%); bimë industriale (970,05 ha, ose 0,51%); kultura të tjera (2 778,23 ha, ose 1,47%)

dhe tokë djerrinë ishte 6 274,62 ha ose 3,33%.

Sipërfaqe e ujitur, të paktën një herë gjatë periudhës referuese të anketës në vitin 2022, ishte 34 247,97 ha.

Kurse, gjithsej sipërfaqja e trajtuar me pesticide në vitin 2023 ishte 122 752,16 ha.

Rezultatet e kësaj ankete tregojnë se blegtoria në Kosovë, gjatë vitit 2023, sa i përket numrit të gjedheve ishte 247 493, ku krahasuar me vitin paraprak 2022 (që ishte 250 899), ka një rënie të lehtë.

Sa i përket numrit të deleve gjatë vitit 2023 ishte 207 123, ku krahasuar me vitin paraprak 2022 (që ishte 204 110), ka një rritje të lehtë.

Ky publikim ofron të dhëna në formë përmbledhëse për kulturat bujqësore bimore (shfrytëzimin e tokës bujqësore, prodhimtarinë bimore, inputet bujqësore (plehurat minerale, organike, pesticidet)); blegtorinë: therjet, shitjet, produktet blegtorale dhe shpenzimet në ekonominë bujqësore.

Metodologjia dhe standardet e aplikuara në AEB 2023 (përkufizimet - definicionet, pyetësori, dhe udhëzuesi) janë të harmonizuara me rekomandimet e Eurostatit.

Kurti takon ish-kreun e BERZh-it, i flet për "progresin e jashtëzakonshëm ekonomik" që nga çlirimi

PRISHTINË, 12 QERSHOR - Kryeministri Albin Kurti ka zhvilluar një takim me ish-presidentin e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZh) dhe kryesuesin e organizatës ODI Global, Sir Sumantra Chakrabarti, dhe CEO-n e ODI-së, Sara Pantuliano, të cilët kanë udhëtuar në Prishtinë këtë javë për nder të 25-vjetorit të Çlirimit të Kosovës. Në këtë takim, siç ka njoftuar Kurti, është biseduar për

anëtarësimin e Kosovës në BERZh në vitin 2012, anëtarësim që erdhi gjatë mandatit të Sir Suma si president i këtij institucioni ndërkombëtar financiar. Po ashtu, në takim është biseduar edhe për, siç tha Kurti, "progresin e jashtëzakonshëm ekonomik dhe demokratik" të vendit që nga çlirimi, 25 vjet më parë. "Gjatë një drekë me kuzhinën tonë tradicionale, diskutuam për anëtarësimin e Kosovës në

BERZh në fillim të mandatit të Sir Suma si President; progresin tonë të jashtëzakonshëm ekonomik dhe demokratik që nga çlirimi, veçanërisht gjatë viteve të fundit; dhe punën e gjerë dhe të avancuar të ODI në të gjithë Evropën, Mbretërinë e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara", tha Kurti në një postim në "X". Ai tha se pret me padurim që t'i vazhdojnë takimet edhe në të ardhmen.



Kosova, 25 vjet pas luftës

Lufta e Kosovës përfundoi më 10 shtator 1999. Atë ditë, Këshilli i Sigurimit i OKB-së në Nju Jork miratoi Rezolutën 1244, e cila i dha fund zyrtarisht luftimeve, të cilat kishin pushuar një ditë më parë, pas nënshkrimit të Marrëveshjes Teknike-Ushtarake në Kumanovë. Dy muaj e gjysmë më parë, në mbremjen e 24 marsit 1999, NATO kishin filluar bombardimet e para të caqeve në Jugosllavi (e përbërë nga Serbia dhe Mali i Zi). Ishte ky misioni i parë luftarak i Aleancës së Mbrojtjes së Atlantikut të Veriut pa mandat të OKB-së dhe i pari me pjesëmarrjen e ushtarëve gjermanë. Ishte një shkelje e tabusë – për NATO-n për shkak të mungesës së një mandati të OKB-së dhe për publikun gjerman për shkak të përfshirjes së saj në një luftë. Qëllimi i NATO-s ishte të detyronte ushtrinë jugosllave të tërhiqej nga Kosova për të parandaluar dëbimet dhe shkeljet e të drejtave të njeriut ndaj shqiptarëve të Kosovës që jetonin atje.

Shpërbërja e Jugosllavisë filloi në vitin 1991 me shpalljen e pavarësisë nga Sllovenia, Kroacia dhe Maqedonia. Bosnjë-Hercegovina pasoi në vitin 1992. Serbia udhëhoqi ose nisi luftërat kundër Sllovenisë, Kroacisë dhe Bosnjë-Heercegovinës, vetëm Maqedonia u kursye nga forcat serbe.

Edhe në Kosovë, shenjat e hershme tregonin për një përshkallëzim: qysh në vitin 1989, kryetari i Lidhjes së Komunistëve në Serbi, Slobodan Millosheviq, i hoqi autonominë krahinës së Kosovës. Largimi i shqiptarëve nga administrata shtetërore dhe sektori publik (shëndetësia dhe arsimit) në Kosovë kishte filluar më parë dhe u zgjerua masivisht me heqjen e autonomisë. Për një kohë të gjatë pati rezistencë jo të dhunshme nga shqiptarët e Kosovës, të udhëhequr nga shkrimtari Ibrahim Rugova, i cili më vonë u bë presidenti i parë i Kosovës.

Nga mesi i viteve 1990, përkrahësit e rezistencës së dhunshme kundër Serbisë u bënë gjithnjë e më popullore. Ata ishin organizuar në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës



(UÇK). Forca fillimisht e vogël u rrit shpejt dhe u shndërrua në një fuqi më të madhe në gjysmën e dytë të viteve 1990.

Lufta para bombardimeve të NATO-s

Këto forca ndërmorrën aksione kundër stacioneve dhe pikëve të tjera të policisë serbe, të cilave Beogradi iu përgjigj me ashpërsi disproporcionale. Konfliktet e armatosura u shndërruan në një luftë në Kosovë, në periudhën 1998/1999. Shkaku për ndërhyrjen e NATO-s është zbulimi i trupave të 40 shqiptarëve të vdekur kosovarë në fshatin Reçak në janar të vitit 1999. Vëzhguesit ndërkombëtarë të drejtuar nga Willian Walker folën për vrasje masive të civilëve, gjë që u mohua nga pushtetarët e Beogradit.

Konferenca e Rambujesë dhe fundi i diplomacisë

Negociatat e paqes mes palës serbe dhe asaj të Kosovës, me ndërmjetësimin ndërkombëtar, u zhvilluan në Rambuje afër Parisit në shkurt 1999. Bisedimet u mbajtën nën udhëheqjen e Grupit të Kontaktit. Këto ishin përpjekjet e fundit diplomatike të evropianëve

dhe të SHBA-së për t'i detyruar shqiptarët dhe serbët e Kosovës t'i japin fund luftimeve me një marrëveshje.

Por negociatat dështuan. Një përpjekje e fundit nga i dërguari i posaçëm i SHBA Richard Holbrooke për të bindur njeriun e fortë të Serbisë Millosheviq të dorëzohej në Beograd dështoi po ashtu vetëm pak kohë para fillimit të bombardimeve.

Polemika për mungesën e një mandati të OKB-së

Në prag të sulmeve ajrore të NATO-s, politikanët perëndimorë, duke përfshirë presidentin amerikan Bill Clinton në veçanti, e kishin akuzuar vazhdimisht Serbinë për planifikimin e gjenocidit në Kosovë. NATO nuk kërkoi një mandat të OKB-së për këto bombardime, sepse ekzistonte dyshimi se do të kishte dështuar për shkak të rezistencës nga Rusia dhe Kina në Këshillin e Sigurimit të OKB-së. Për koalicionin e atëhershëm të qeverisë gjermane të përbërë nga socialdemokratët (SPD) dhe ekologjistët, pjesëmarrja në luftë me disa avionë luftarakë ishte një vendim delikat. Pacifistët

dhe mbështetësit e ndërhyrjes ishin kundër njëri-tjetrit në Gjermani.

I ashtuquajtur "plani patkoi" i Serbisë (për dëbimin e shqiptarëve nga Kosova) kishte për qëllim t'i jepte qeverisë federale justifikimin e nevojshëm për pjesëmarrjen gjermane në luftën e Kosovës. Plani për të cilin flitej se ekzistonte në Beograd, kishte për qëllim të dëbonte popullsinë shqiptare përtej kufirit jugor të Kosovës në Shqipëri. Zyrtarisht nuk është konfirmuar nëse ky plan ka ekzistuar në të vërtetë. Por është e padiskutueshme se qindra mijëra shqiptarë të Kosovës u larguan ose u dëbuan nga shtëpitë e tyre dhe kaluar në radhë të parë në Shqipëri e Maqedoni.

Dorëzimi i Millosheviçit

Shumica e ekspertëve sot pajtohen se bombardimet e NATO-s zgjatën më shumë se njëmbëdhjetë javë për shkak të llogaritjeve të gabuara reciproke të palëve. NATO ishte e bindur se Millosheviqi do të dërgonte sinjale për negociatat pas disa ditësh bombardime.

Nga ana tjetër, në Beograd spekulohet se NATO do të dorëzohej dhe do të vinte një kompromis në tryezë. Në fund të fundit, Millosheviçi u dorëzua, ndoshta sepse Moskë po ushtronte ndikim në Beograd. Rusia, e cila kishte vështirësi të mëdha ekonomike në atë kohë, kishte nevojë për bashkëpunim me Perëndimin, mendon edhe ish-përfaqësuesi special i BE-së për Kosovën, austriaku Wolfgang Petritsch.

Rezoluta 1244 e OKB-së dhe Marrëveshja e Kumanovës

Përfundimi i luftës u rregullua me dy akte juridike ndërkombëtare. Marrëveshja Teknike-Ushtarake në

Kumanovë më 9 qershor 1999, një qytet në atë që sot quhet Maqedonia e Veriut, parashikonte tërheqjen e ushtrisë jugosllave dhe forcave serbe nga Kosova. Përgjegjësia e sigurisë për rajonin kaloi me këtë Marrëveshje në duart e NATO-s. Marrëveshja parashikonte edhe çarmatimin e UÇK-së.

Një ditë më vonë, Këshilli i Sigurimit i OKB-së miratoi Rezolutën 1244, të njohur edhe si Rezoluta e Kosovës. Ajo formoi bazën ligjore ndërkombëtare për zgjidhjen e krizës së Kosovës. Rezoluta përcaktoi se Kosova do të mbetej pjesë përbërëse e Republikës Federale të Jugosllavisë, ndonëse me autonomi shumë të gjerë. Për të krijuar një administratë civile, Kombet e Bashkuara krijuan UNMIK-un, një mision të përkohshëm të administratës ndërkombëtare. OKB-ja dërgoi forcën ndërkombëtare ushtarake të KFOR-it për të garantuar sigurinë në Kosovë. Por statusi përfundimtar i Kosovës mbeti i paqartë në këtë Rezolutë.

Pavarësia e Kosovës

Pas 78 ditësh, rreth 2.300 sulmeve ajrore dhe mijëra të vdekurve, ndërhyrja e NATO-s përfundoi. Lufta e Kosovës, e cila kishte filluar një vit e gjysmë më parë, mori fund.

Nëntë vjet më vonë, më 17 shkurt 2008, Kosova u shpall e pavarur dhe tani njihet nga rreth 115 nga 192 shtetet anëtare të OKB-së, përfshirë edhe SHBA, Gjermaninë, Britaninë e Madhe, Francën... Por Rusia dhe Kina si dhe pesë vende të BE-së (Greqia, Rumania, Spanja, Sllovakia, Qipro) nuk e kanë njohur Kosovën si shtet. Serbia edhe sot e kësaj dite pretendon se Kosova është pjesë e saj dhe refuzon ta njohë pavarësinë e Kosovës. / DW



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Sylvinho: Italia është favorite, por gjithçka mund të ndodhë

ROMË, 12 QERSHOR - Në një intervistë për "Corriere Della Sera", trajneri i kombëtares së Shqipërisë, Sylvinho është shprehur se nuk i druhet parashikimeve, që nuk i japin shumë shanse skuadrës së tij në "Euro 2024". Sipas teknikut, kuqezinjët nuk frikësohen nga rivalët dhe se gjithçka mund të ndodhë në futboll. Italinë e njeh mirë, kjo për shkak të aventurës së tij në pankinën e Interit si

zëvendës i Roberto Mançinit. Nga ajo kohë, trajneri i Kombëtares së Shqipërisë, Sylvinho ruan vetëm kujtime të bukura. Tekniku kuqezi i ka kujtuar ato në një intervistë për "Corriere Della Sera". "Gjatë shortit mendova, fatmirësisht nuk është ai në stol. Të luaja kundër tij do të ishte e çuditshme. Gjithsesi, me apo pa Mançinin, për ne do të jetë e vështirë. Si një brazilian, Italia

më ka bërë për të qarë në 1982 me Paulo Rossi, por unë e dua shumë atë. Kam marrë shumë, ai është një menaxher i shkëlqyer, i njeh lojtarët, ka personalitet, lidhshmëri, qetësi. Unë shpresoj vetëm që t'i kem dhënë diçka atij", ka deklaruar Sylvinho. Në llogaritë e grupit B të "Euro 2024", kuotat e Shqipërisë janë shumë të ulëta. Ashtu janë edhe për ndeshjen e parë kundër Italisë më 15 qershor. Por Sylvinho

beson te forca e futbollistëve të tij. "Nuk e morëm keq shortin, dëshirojmë të luajmë kundër më të mirëve. Jemi një përfaqësuese e re, kjo është hera e dytë që marrim pjesë në një Evropian, pas 2016 me De Biasin. Jemi rritur shumë, por duhet të mësojmë akoma më shumë. Duhet ta shfrytëzojmë me përgjegjësi këtë moment, jemi të karikuar. Është e drejtë që Italia të jetë favorite, por futbollit është i



çmendur, mund të ndodhë gjithçka", ka shtuar Sylvinho. I pyetur për pikën më të fortë të kombëtares së Shqipërisë, Sylvinho është shprehur për të përditshmen italiane, se ajo është grupi dhe organizimi.

Kurti pret kampionët e Superligës: Qeveria është e hapur për KF Ballkanin

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 12 QERSHOR - Kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, e ka pritur në takim stafin dhe lojtarët e KF Ballkanit. Shefi i ekzekutivit ka thënë se qeveria është e hapur për klubin kampion të Kosovës. Kurti ka thënë se për tre vjet rresht, Ballkani u bë tri herë kampion në Superligën e futbollit, ndërkaq përmendi edhe suksesin e sivjetmë të klubit suharekas, të cilët e fituan për edhe Kupën e Kosovës. "Ky sukses i jashtëzakonshëm shkon për klubin futbollistik KF Ballkani nga qyteti i Suharekës, që pa dyshim është shndërruar në qytet të sportit. Me gjithë këto succese, me pjesëmarrje edhe në garat kualifikuese për Ligën e

Kampionëve, me shumë lojtarë që nga ky klub tash janë pjesë e shumë ekipeve të njohura në Evropë e më gjerë, e ardhmja e kampionit aktual të futbollit në Kosovë është pa dyshim edhe me më shumë succese", ka shkruar Kurti, i cili me pas ka falënderuar stafin dhe lojtarët për emocionet e festat këtë stinor, por edhe për dhuratën që klubi ia bëri atij. "Faleminderit edhe për dhuratën e veçantë, topin e futbollit me nënshkrimet e futbollistëve kampion, me të cilin Ballkani e filloi ndeshjen historike në pjesëmarrjen e parë të ndonjë klubi vendor në Ligën e Konferencës", ka shkruar Kurti. Skuadra e Ballkanit si kampion i Kosovës do të marrë pjesë në garat evropiane, përkatësisht në



kualifikimet për fazën e grupeve në Ligën e Kampionëve. Ndërsa klubi nga Suhareka është ndarë i kënaqur me pritjen dhe mbështetjen që ka marrë nga kryeministri Albin Kurti dhe ministri Hajrullah Çeku. "Ishim të nderuar të ftohemi në ambientet e Qeverisë së Republikës së Kosovës nga kryeministri Albin Kurti. I pari i Qeverisë e ka përgëzuar punën që

bëhet në klubin tonë, duke e vlerësuar jo vetëm si sukses sportiv shtetëror, por edhe si inspirim për djemtë dhe vajzat e reja të Kosovës, për t'i ndjekur ëndrrat e tyre. Poashtu z.Kurti dhe ministri Çeku u shfaqën të hapur për ta mbështetur FC Ballkanin, pasi rrugëtimi i suksesshëm në Evropë, ka forcuar në përgjithësi futbollin e Republikës, duke u përfaqësuar

tani me katër skuadra në Evropë. Presidenti i klubit, Arsim Kabashi, i bëri dhuratë kryeministrit fanellën e FC Ballkanit, të personalizuar me emrin e tij, teksa premtoi që do të vazhdohet me intensitet edhe më të lartë të punohet në vazhdim, në mënyrë që Kosova të përfaqësohet gjithmonë sa më dinjitetshëm nga kampioni i saj. Nga ana tjetër nikoqirët komplimentuan edhe punën e trajnerit, Ilir Daja, i cili nxori më të mirën nga secili lojtar, për të renditur succese si brenda ashtu edhe jashtë vendit. Në fund, futbollistët tanë kampionë i bënë edhe një dhuratë kryeministrit, duke ia nënshkruar topin e kompeticionit ku dy herë garuam në grupe, UEFA Europa Conference League", thuhet në njoftimin e Ballkanit.

Drita prezanton katër futbollistë

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

GJILAN, 12 QERSHOR - Skuadra e Ditës ka filluar të përforcohet për edicionin e ri futbollistik 2024/2025. Skuadra nga Gjilani ka prezantuar katër futbollistë brenda 24 orëve. Veton Tusha, Ilir Mustafa, Kastriot Rapuca dhe Blerton Sheji janë tri transferet e skuadrës nga Gjilani. "Kemi kënaqësinë të ju njoftojmë me lojtarin tonë më të ri, sulmuesin Veton Tusha i cili është ardhja jonë e radhës e këtij afati kalimtarë nga Dinamo City. Tusha ka nënshkruar kontratë 3-vjeçare



dhe do të jemi së bashku deri në qershor 2027", thuhet në njoftimin

e Dritës. Tusha është pjese e Përfaqësueses së Kosovës U21 dhe do të jetë një forcë shtesë në repartin ofensivë për trajnerin Zekirja Ramadani. Transferi tjetër i Dritës është Ilir Mustafa, i cili ka bërë karrierë në disa klube kosovare, por ka përvojë edhe në Ligën e Parë të Turqisë. "Iliri nga sezoni 2015/16 është pjesë e Superligës së Kosovës ku ka luajtur për ekipe si Liria, Dukagjini dhe së fundmi Malisheva. Iliri ka luajtur edhe jashtë kampionatit tonë ku në sezonin 2020/21 ka luajtur në Ligën e Parë të Turqisë. Mustafa do të jetë një forcë shtesë

për sezonin e ri dhe do të jetë pjesë e klubit tonë për dy sezonet e ardhshme deri në qershor 2026", thuhet në njoftimin e Dritës. Përforcimi i tretë është Kastriot Rapuca, i cili në tre sezonet e fundit ka qenë pjesë e Superligës së Kosovës me ekipe si Ulpiana, Malisheva dhe së fundmi me ekipin e Fushë Kosovës. Kemi kënaqësinë të ju njoftojmë me lojtarin tonë më të ri, mbrojtësin e krahut të djathtë Kastriot Rapuca i cili është ardhja jonë e parë e këtij afati kalimtarë. Rapuca do të jetë një forcë shtesë në repartin defensivë dhe një konkurrent i fortë

nën drejtimin e trajnerit Zekirja Ramadani. Rapuca ka nënshkruar kontratë dy vjeçare dhe do të jemi së bashku deri në qershor 2026", ka njoftuar skuadra e Dritës. Futbollisti i katërt është Blerton Sheji, i cili vjen në Gjilan nga kampionati i Maqedonisë së Veriut ku për tre sezone ishte pjesë e FC Shkupit. Para se të transferohej në Shkup, Blertoni ishte pjesë edhe e FC Struga TrimLum për dy sezone 2019/20 dhe 2020/21. Drita kampionatin e përfundoi në vendin e tretë, por do të jetë pjesë e garave ndërkombëtare bashkë me Ballkanin, Llapin dhe Malishevën.

Llapi finalizon transferimin e Mulajt

Podujevë, 12 qershor - Skuadra e Llapi të mërkurën ka njoftuar se ka finalizuar transferimin e talentit të ri, Erlind Mulaj. Ai ka nënshkruar kontratë profesionale me klubin llapian. 18-vjeçari është sulmues i krahut të majtë,

derisa ka shkëlqyer me aftësitë e tij në fushën e lojës. Duke filluar karrierën e tij te FC Istogu, ai ka debutuar në ekipin e parë që në moshën 16-vjeçare dhe ka kontribuar me 3 gola të realizuar. Statistikat e tij impresionuese

përfshijnë 43 gola dhe 32 asistime në U-19 të FC Istogu gjatë dy sezoneve me ekipin, një sezon në Ligën e Parë dhe së fundmi në Superligë. "Transferimi i Erlind Mulaj është një hap i rëndësishëm për KF Llapin në përpjekjet

tona për të forcuar ekipin tonë dhe për të zhvilluar talentë të rinj në fushën e futbollit. Ne e mirëpresim Erlindin në familjen tonë dhe i urojmë atij sukses në rrugën e tij të re me KF Llapin", thuhet në njoftimin e Llapi.



Southgate: Nëse nuk fitojmë do të largohem

LONDËR, 12 QERSHOR - Është shansi i fundit për të fituar trofe, të paktën me të në krye të pankinës. Vetëm pak ditë para nisjes së Kampionatit Evropian të futbollit, në Gjermani, tekniku i Kombëtares së Anglisë, Gareth Southgate është shprehur se nëse nuk e fitojnë këtë kompeticion me shumë

mundësi mund të largohet nga stoli i "Tre Luanëve". Në prononcimin të bërë së fundmi për mediat, tekniku anglez theksoi se ky mund të jetë shansi i tij i fundit, ndërsa shtoi se nuk mund t'u thotë tifozëve që të presin edhe më ndonëse ka tetë vite në krye të Anglisë, sepse sipas tij në një moment

njerëzit do të humbasin besimin në punën e "ishullorit". "Nëse nuk fitojmë, ndoshta nuk do të jem më këtu. Mund të jetë shansi i fundit. Mendoj se gjysma e trajnerëve kombëtarë largohen pas një turneu, kjo është natyra e futbollit ndërkombëtar. Kam qenë këtu për gati tetë vjet dhe

jemi afër për të fituar Kampionatin Evropian, kështu që e di që nuk mund të vazhdojmë të qëndrojmë para turmës dhe të themi 'ju lutem, prisni edhe pak', sepse në një moment njerëzit do të humbasin besimin dhe unë dua të jem një trajner i klasit të lartë, kështu që ne duhet të



jemi në lartësinë e momenteve të mëdha", ka deklaruar Southgate.

Cana: Nuk kemi çfarë humbasim në 'Euro 2024'

Tiranë, 12 qershor - Kapitani legjendar kuqezi, Lorik Cana, në një intervistë për mediat italiane, foli për sfidën e parë të Shqipërisë në "Euro2024", atë kundër Italisë. "Shqipëria nuk ka asnjë për të humbur, duhet të mbështet te rruga e tyre në rritjes, ashtu siç bëri edhe gjatë fazës kualifikuese ku e mbylli grupin në vendin e parë. Nuk kishte ekipe 'big', por skuadra bëri një punë të madhe, me një Sylvinho i cili u tregua i zoti të shfrytëzonte të gjithë materialin që kishte në dispozicion dhe që i lejoi përfaqësueses tonë të merrte pjesë në Evropian", ka thënë Cana. "Më pas qëlluan në grupin më të vështirë, kjo na jep më pak presion, por vështirësia është shumë e madhe. Shqipëria është në një moment ku nuk ka një pikë referimi të qartë, kjo pasi akoma nuk është përplasur me një ekip 'big'. Kjo u pa edhe gjatë fazës kualifikuese, ku kishim një Poloni nën ton dhe



një Republikë Çeke që është një skuadër e mirë, por nuk është një nga ekipet 'big' të kontinentit", ka shtuar Cana. "Tani steka është ngritur dhe të shohim se çfarë do të dalë në pah, por në çdo rast, Shqipëria mbetet një skuadër me vlera: mbrohem shumë mirë, kemi

një shtyllë kurrizore e gjitha italiane, pa llogaritur këtu edhe disa emra risi, kemi më shumë cilësi në mesfushë dhe në sulm. Është e rëndësishme të shohim edhe cilësitë e Brojes, nëse është mirë do të jetë shpërthyes", përfundoi analizën e tij Lorik Cana.

SHKURT

'Heatrex', sponsor i Shqipërisë në 'Euro 2024'

Federata Shqiptare e Futbollit (FShF) ka njoftuar për marrëveshjen e nënshkruar me kompaninë "Heatrex", që kjo e fundit të jetë sponsori i Kombëtares së Shqipërisë në Kampionatin Evropian "Euro 2024" në Gjermani. "Heatrex" do të jetë sponsori i Shqipërisë gjatë Evropianit "Gjermania 2024", dhe ky partneritet vjen si mbështetje dhe promovim për vlerat e futbollit shqiptar gjatë "Euro 2024". "Heatrex" që është një kompani e specializuar për pompat e nxehtësisë dhe industrinë fotovoltaike në Ballkan dhe më gjerë, i shtohet gamës së gjerë të sponsorave që mbështesin FShF-në për të kontribuar dhe zhvilluar futbollin në Shqipëri.

Buffon: Ndaj Shqipërisë do të jetë një ndeshje shumë delikate

Në letër nuk ka garë. Në të gjitha parashikimet Italia shihet si favorite në ndeshjen e 15 qershorit kundër Shqipërisë, e para për dy skuadrat në finale të "Euro 2024". Por për dikë që ka luajtur më shumë se 30 vite futboll, duke fituar gjithçka në karrierë, e di mirë që vetëm fusha vendos. Për këtë arsye, Gigi Buffon nuk i beson parashimeve në prag të sfidës të së shtunës. "Kemi në fillim ndeshjen me Shqipërinë, që në letër duket se është sfida që mund të përballohet më lehtë në grupin tonë. Por nuk është kështu, mendoj se do të jetë një ndeshje mjaft delikate për Italinë. Delikate, sepse e para është ndeshja debutuese në Evropian dhe të gjitha sfidat e para janë të vështira, pasi duhet të 'thyesh akullin'. Buffon vlerëson skuadrën kuqezi, që përveç kualitetit, në Dortmund do të kenë me vete edhe entuziazmin e tifozëve. "Është një ndeshje e vështirë, sepse Shqipëria është një skuadër në rritje dhe mbi të gjitha do të ketë një mbështetje publiku të jashtëzakonshme në Gjermani. Mbjaj mend që kur shkuan në Evropianin e Francës në 2016-ën, në ndeshjet e tyre në stadium ishin 80% shqiptarë dhe 20% pjesa tjetër e tifozëve. Dhe jam i bindur që kështu do të jetë edhe të shtunën në Dortmund", ka deklaruar Buffon. Kundër Shqipërisë, të kaltërit do të nisin misionin e tyre për mbrojtjen e titullit kampion Evropë. Një objektivi vështirë, por që Buffon është shpresëplotë se mund të arrihet.

Lëndohet Pavloviqi, ftohet Emre Can

Julian Nagelsmann ka marrë një lajm të rëndë vetëm dy ditë para se të nisë Kampionatin Evropian "Euro 2024". Trajneri i Kombëtares së Gjermanisë është dashur të bëjë ndryshime në listë. Mesfushori i talentuar i Bayern Munchen, Aleksandar Pavloviq është larguar nga lista finale. "Aleksandar Pavloviq do të humbas 'Euro 2024' për shkak të bajameve", ka shkruar "Bild". Mediumi gjerman ka raportuar se trajneri i Gjermanisë e ka thirrur Emre Canin si zëvendësues të Pavloviq. Can i cili ishte në Kosovë dhe në Shqipëri së fundmi ka lënë pushimet në gjysmë dhe është nisur drejt Gjermanisë, ku do t'i bashkohet Kombëtares.

'Eurosport': Franca, favorite në 'Euro 2024'

LONDËR, 12 QERSHOR - Kur jemi dy ditë larg nisjes së "Euro 2024" në Gjermani, kanë nisur natyrshëm edhe parashikimet se cilët janë kandidatët për të ngritur lart trofeun, mbrëmjen e 14 Korrikut në Berlin. Prestigjiozja "Eurosport", duke analizuar futbollistët si dhe gjendjen aktuale të të 24 skuadrave pjesëmarrëse, ka bërë një projektion se si do të jetë renditja finale e skuadrave. Për vendin e parë, sipas "Eurosport" nuk ka dyshime: Franca e Didier Deschamps mbetet favoritja absolute për të fituar trofeun. 8 nga 12 gazetarët e redaksisë së "Eurosport" e shikojnë Francën si favoriten kryesore të këtij evropiani. "Gjelat", e kërkojnë këtë trofe prej 24 vitesh, ata iu afruan shumë në 2016, ku në shtëpi i surprizoi Portugalia e Cristiano Ronaldos. Antagonistja kryesore e Francës është Anglia e



Gareth Southgate. Në linjën e dytë të pretendentëve janë Gjermania, vendi pritës i këtij evropiani, drejtuar nga Nagelsmann dhe Spanja e De La Fuentes, rivali i Shqipërisë, mbrëmjen e 24 Qershorit, në Dusseldorf. Ndërkohë që Italia e Spalletit, rivali tjetër i kombëtares kuqezi në

Grupin B, shikohet vetëm në vendin e gjashtë dhe mundësia për të përsëritur suksesin e Evropianit të shkuar shikohet thuajse e pamundur. Pjesa më e madhe e gazetarëve të "Eurosport" parashikon se "Azzurrët" do të eliminojnë përpara raundit të gjysmëfinaleve.

Ronaldo: Jam i dashuruar me futbollin, po e shijoj momentin

Cristiano Ronaldo ka qenë edhe një herë protagonist. Ylli i Al-Nassr i realizoi dy gola për Portugalinë në fitoren 3-0 ndaj Irlandës, në miqësoren para "Euro 2024".

39-vjeçari me këtë rast arriti në kuotën e 130 golave për Portugalinë, derisa është golashënuesi më i mirë në histori të Kombëtareve. Gjithashtu, ai shkoi në shifrën e 895 golave në

karrierë, një numër i jashtëzakonshëm dhe i paarrtshëm deri tash. Derisa po i kalon vitet e fundit të karrierës, ish-futbollisti i Sporting Lisbonës, Manchester Unitedit,

Real Madridit dhe Juventusit thotë se po e shijon çdo moment. "Nuk më kanë mbetur shumë vite në futboll. Kështu që, më duhet ta shijoj këtë", ka deklaruar fillimisht CR7 pas lojës.

"Jam i dashuruar me futbollin. Çdo ndeshje është speciale, imagjinojeni në 'Euro 2024' me Portugalinë, ndihem krenar... Është një ëndërr, njëjtë si kur isha 20 vjeçar", ka shtuar Ronaldo.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania “Bllok Group” Sh.p.k. Strazhë, Novobërdë, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për fabrikën e prodhimit të bazës së asfaltit në Koretishtë, Novobërdë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 31.07.2024 në ora 10:00 në hapësirat e shkollës SHFMU "Petar Petroviç Njegos" fshati: Kufca e Epërme, Komuna e Novobërdës, do të organizohet debat publik nga Kompania “Bllok Group” Sh.p.k. Strazhë, Novobërdë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

[https://us05web.zoom.us/j/2693380475?pwd=ZEpzTUNmaHlTRVn3VXZqRU5kaXRTUT09;](https://us05web.zoom.us/j/2693380475?pwd=ZEpzTUNmaHlTRVn3VXZqRU5kaXRTUT09;password:BBqP2x)
password: BBqP2x

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë “Bllok Group” Sh.p.k. Strazhë, Novobërdë, për fabrikën e prodhimit të bazës së asfaltit në Koretishtë, Novobërdë.

<https://mmpfi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Pastrimi Pika” SH.P.K. me pronar Luljeta Tahiri me seli në Gjilan, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 810142018 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavajte se svi klienti da drustvo sa “Pastrimi Pika” D.O.O. Luljeta Tahiri Gnjilane, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810142018 ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Pastrimi Pika” L.L.C. Luljeta Tahiri with headquarters Gjilan, has come to the decision to quit its business: 810142018 the company has appointed a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania “ANAHITA” Sh.p.k Istog, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për fabrikën e ambalazhimit të ujit në Cerrcë, Istog.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 01.08.2024 në ora 10:00 në hapësirat e Shtëpisë të Kulturës “Adem Jashari” në Istog, do të organizohet debat publik nga Kompania “ANAHITA” Sh.p.k Istog, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us04web.zoom.us/j/4549344495?pwd=GbKcoccSWx39F3e8QF7PsAkCM3bvK6.1>

Meeting ID: 454 934 4495

Passcode: Aela2019.

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë “ANAHITA” Sh.p.k Istog, për fabrikën e ambalazhimit të ujit në Cerrcë, Istog.

<https://mmpfi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Ambulanca Neuropsikiatrike “Mens Sana” shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 70933225.

- Miran Xhelili, shpall të pavlefshme Licencën e Punës të lëshuar nga Oda e Infermierëve, Mamive dhe Profesionistëve tjerë shëndetësorë të Kosovës, me nr. KO-46627/A-05-20 Diploma: 0148/9 datë, 24.06.2013 Gjilan.

- Altin Kamberi nga Gjakova shpall të pavlefshme certifikatën e testit të maturës të Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Florije Rama Molliq KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e plotë sh.f.m.u. “Bajram Sadriu” Berjah nga kl. 1-8.

- Qëndresa Gjokaj nga Gjakova shpall të pavlefshme certifikatën e testit të maturës të sh.m.e. “Kadri Kusari” Gjakovë.

- Tahir Asllani Brovin KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12. të Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Mimoza Paloja nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën dhe dëftesat kl. 10.11.12.13. të sh.m.e. “Kadri Kusari” Gjakovë.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



MEKA

HALAL FOOD

TRADITË QË NGA

1992

